

## AKT THEMELIMI

### I

## SHOQËRISË “Infotelecom-Albsolar 2” SHPK

Sot, më datë 03.03.2022 (dymijë e njëzet e dy), në praninë e Ortakëve Themelues të shoqërisë “Infotelecom-Albsolar 2” SHPK si më poshtë:

- 1. Shoqëria “INFO-Telecom” SHPK**, shoqëri e së drejtës shqiptare, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS K92402002P, me seli në Tiranë, Shqipëri, në adresën: Rruga "Faik Konica" nr. 1, Pallati Kuq përballë Fakultetit Ekonomik, përfaqësuar nga Administratori Z.Marín Gjonaj, sipas Vendimit të Ortakut të vetëm datë 03.03.2022.
- 2. Shoqëria “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” SHPK**, shoqëri e së drejtës shqiptare, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS J82427007R, me seli në Tiranë, Shqipëri, në adresën: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga “Sami Frashëri, nr.56, shkalla F, kati.1, zyra.2, nr.pasurie 7/630-N30, (pjesa prej 71.5 m), zona kadastrale 8270, përfaqësuar nga Administratori Z.Behar Male sipas Vendimit të Ortakut të Vetëm datë 03.03.2022.

Bazuar në nenet 6 e vijues të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), nënshkruhet ky Akt Themelimi, në të cilin Ortakët Themelues shprehin vullnetin të themelojnë shoqërinë tregtare “Infotelecom-Albsolar 2” SHPK, me kushtet si vijon:

### NENI 1

#### Emri i shoqërisë

- 1.1. Emri i shoqërisë do të jetë “Infotelecom-Albsolar 2” SHPK.
- 1.2. Ortakët themelues të shoqërisë gëzojnë përgjegjësi të kufizuara deri në pjesët respektive të pashlyera të kontributeve të nënshkruara.

### NENI 2

#### Forma e shoqërisë

- 2.1. Forma e shoqërisë Infotelecom-Albsolar 2” SHPK (në vazhdim referuar si “Shoqëria”) do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.
- 2.2. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

### NENI 3

#### Selia e shoqërisë

- 3.1. Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, Shqipëri, në adresën: Rruga “Rruga "Faik Konica" nr. 1, Pallati Kuq përballë Fakultetit Ekonomik.
- 3.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjetër brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.





#### NENI 4

##### Kohëzgjatja e Shoqërisë

- 4.1. Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 4.2. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e tij një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

#### NENI 5

##### Objekti i veprimtarisë

- 5.1. Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në të: *“Veprimtari në fushën e prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, siç është prodhimi i energjisë nga burime fotovoltaike, ruajtja dhe tregtimi i kësaj energjie brenda dhe jashtë vendit. Sipas legjislacionit në fuqi, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të konsideruar të dobishëm apo të nevojshëm, për arritjen e objektivave të saj, i cili lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi.”*

#### NENI 6

##### Kapitali i Shoqërisë

- 6.1. Kapitali bazë i shoqërisë është në vlerën 100 (njëqind) lekë, i përbërë nga 2 (dy) kuota, ku kuota e zotëruar nga ortakut “INFO-Telecom” SHPK jep të drejtën e pjesëmarrjes me 80% (tetëdhjetë përqind) në kapitalin bazë, si dhe të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë, ndërsa kuota e zotëruar nga ortakut “Tirana International Development” SHPK jep të drejtën e pjesëmarrjes me 20% (njëzet përqind) në kapitalin bazë, si dhe të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë,
- 6.2. Kuota e ortakut “INFO-Telecom” SHPK ka vlerë nominale 80 (tetëdhjetë) lekë, ndërsa kuota e ortakut “Tirana International Development” SHPK ka vlerë nominale 20 (njëzet) lekë.
- 6.3. Kapitali bazë është nënshkruar dhe paguar në tërësinë e tij nga ortakët themelues, ku ortakut “INFO-Telecom” SHPK ka nënshkruar dhe paguar vlerën prej 80 (tetëdhjetë) lekë, ndërsa ortakut “Tirana International Development” SHPK vlerën prej 20 (njëzet) lekë.

#### NENI 7

##### Organet Drejtuese

- 7.1. Bazuar në dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), organet drejtuese të shoqërisë janë:
  1. **Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve**, e cila është organi më i lartë vendimmarrës;
  2. **Administratori**, i cili është organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.
- 7.2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

#### NENI 8

##### Administrimi

- 8.1. Shoqëria do të administrohet nga Administratori i saj, i cili mund të zgjidhet për një afat deri në pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.
- 8.2. Administratori i Shoqërisë “Infotelecom-Albsolar 2” SHPK do të jetë **Z.Arben Margilaj**, shtetas shqiptar, lindur më 19.08.1959 në Fier, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr.personal F90819080R, i cili emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë riemërimi.





- 8.3. Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, apo nga një ose disa persona të autorizuar prej tij.

#### **NENI 9**

##### **Ligji i aplikueshëm**

- 9.1. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ky akt themelimi, si dhe parashikimet e Statutit të saj.

#### **NENI 10**

##### **Regjistrimi**

- 10.1. Shoqëria do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga administratori dhe/ose një/disa person(a) të autorizuar prej tij për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 11**

##### **Dispozitat përfundimtare**

- 11.1 Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet nga ortakët e saj themelues.


### **ORTAKËT THEMELUES**

#### **TË**

### **SHOQËRISË “Infotelecom-Albsolar 2” SHPK**

#### **Shoqëria “INFO-Telecom” SHPK**


Përfaqësuar nga Administratori

  
Z. Marin Gjonaj



#### **Shoqëria “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” SHPK**

Përfaqësuar nga Administratori

  
Z. Behar Male

**TIRANA INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT  
TIRANA ALBANIA**